



UNIVERSITETI I GJILANIT "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Rektori
Prof. asoc. dr. Bajram Kosumi

011467

Në bazë të nenit 28, paragrafi 1, pika 1.2 dhe 1.16, të Statutit të Përkohshëm të Universitetit Kadri Zeka në Gjilan,

Rektori i UKZ merr:

V E N D I M

Të gjithë studentëve të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, përkatësisht ata të Fakultetit Ekonomik, të Fakultetit Juridik dhe të Fakultetit të Edukimit, të cilët në vitin akademik 2014/15 kanë arritur sukses në studime duke i kaluar të gjitha provimet deri edhe në afatin e shtatorit 2015, me notë mesatare 9.5 e më shumë, janë përfitues të bursave universitare.

Studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike, të cilët në vitin akademik 2014/15 kanë arritur sukses në studime duke i kaluar të gjitha provimet deri edhe në afatin e shtatorit 2015, me notë mesatare 9 e më shumë, janë përfitues të bursave universitare.

Bursa universitare do të paguhet prej kodit buxhetor të paraparë për këtë vijë, nga shuma prej 7760.00 euro, përkatësisht 267.5 euro për student.

Senati i UKZ do të rishikojë edhe një herë rritjen e vlerës monetare të bursës për secilin student përfitues, nga buxheti i vitit 2016.

Vendimit i bashkangjitet lista e studentëve përfitues.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Gjilan, më 21 dhjetor 2015



Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi
Rektori i UKZ-së